
Tiranë, më _____.____.2020

KALLËZIM PENAL

KALLËZUES: **Besnik CANI**, i biri i Beshir-it, lindur më 25.08.1970, banues në adresën:
Rr. “Don Bosko”, Pallati “Gener 2”, Hyrja A, Apt. 62.

KUNDËR: **Luan DACI**, me detyrë gjyqtar i Kolegjit të Posacëm të Apelimit, me
adresë: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, hyrja përballë Kryeministrisë, Tiranë.

OBJEKTI: 1. Kallëzimi i veprës penale të “Falsifikimit të formularëve”, të
parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal.
2. Pezullimi i ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të Kolegjit të Posacëm të
Apelimit, deri në përfundim të hetimeve.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
Nenet 240, 242, 281 dhe 283 të Kodit të Procedurës Penale;
Neni 190 i Kodit Penal;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve
në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 8577 datë 10.02.2000 i ndryshuar “Për organizimin dhe
funksionimin e Gjykatës Kushteuese të Republikës së Shqipërisë”.

PROKURORISË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

I/E nderuar z./znj. Prokuror/e,

Në datën 06.12.2019, jam njoftuar se do të zhvillohet seanca gjyqësore publike për çështjen me
nr. regjistri (JR) 12/2019, datë 22.02.2019, për ankimin e Komisionerit Publik ndaj vendimit

të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 84, datë 27.11.2018 që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani. Në përbërje të trupit gjykues do të jenë gjyqtarët: znj. Rezarta Schuetz, z. Ardian Hajdari, znj. Albana Shtylla, z. Luan Daci dhe z. Sokol Como.

Pas verifikimeve të kryera nga ana ime ka rezultuar se një anëtarëve të trupit gjykues, përkatësisht z. Luan Daci, jo vetëm gjendet në kushtet e pazgjedhshmërisë, arsye për të cilën kam kërkuar deklarinimin e mbarimit të mandatit të tij nga ana e Kolegjit të Apelit, por veprimet e tij aktive të kryera me qëllim zgjedhjen gjyqtar në Kolegjin e Posacëm të Apelit përmbushin elementët e veprës penale të “*Falsifikimit të formularëve*”, të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal.

Krahas kryerjes së hetimeve të plota dhe të gjithanshme, duke pasur në konsideratë se veprimet e mëtejshme të z. Luan Daci në cilësinë e tij si gjyqtar i Kolegjit të Posacëm të Apelit mund të sjellin pasoja të rënda për të gjitha subjektet e rivlerësimit, të cilëve ju mohohet e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, bazuar në nenin 242 të Kodit të Procedurës Penale, kërkoj marrjen e masës së pezullimit të ushtrimit të detyrës deri në përfundim të hetimeve.

Për këto arsye, bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal, ligjin Nr. 84/2016 “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve*”, ligjin Nr. 8577, datë 10.02.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese*”, i ndryshuar, po parashatroj këtë kallëzim penal për z. Luan Daci, për arsyet si më poshtë:

I. RRETHANAT E CËSHTJES

1. Në jetëshkrimin e depozituar nga z. Luan Daci pranë institucionit të Avokatit të Popullit rezulton se në seksionin “*Arsimimi*” ka vendosur:
 - (i) Shkolla e Mesme e Përgjithshme, mesatare 9.4;
 - (ii) Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, mesatare 8.24 (1993);
 - (iii) Master Shkencor në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (2010);
 - (iv) Kurse në Shkollën e Magjistraturës, Shqipëri (1995 – 1996).Ndërkohë, në seksionin “*Aktiviteti profesional*” ka vendosur:

-
- (i) Avokat, i ushtruar në vazhdim dhe aktualisht me nr. licence 888.
2. Bashkëlidhur jetëshkrimit, ka depozituar edhe një leje Nr. 888, datë 27.03.2000 “*Për ushtrimin e profesionit të avokatit*”, të nënshkruar më 27.03.2000 nga z. Kleanthi Koci. Ndërkohë që rezulton se z. Kleanthi Koci ka ndërruar jetë në datë 21.02.1999. Leja është plotësuar me shkrim dore dhe nuk përmban ndonjë referencë për numër regjistri apo numër protokoli.
3. Nga verifikimi i kryer pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka rezultuar se z. Luan Daci ka aplikuar për gjashtë vende vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të shpallura nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin Nr. 115, datë 09.11.2016. Nga dokumenti “*Curriculum Vitae*” i depozituar nga z. Daci pranë KLD-së kanë rezultuar këto të dhëna për arsimin:
- (i) Shkolla e Mesme e Përgjithshme, mesatare 9.4;
- (ii) Fakulteti i Drejtësisë, mesatare 9;
- (iii) Master Shkencor në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës;
- (iv) Fakultet i dytë Nutricion + Gjenetikë, Tiranë;
- (v) Kurse të Shkollës së Magjistraturës, Shqipëri dhe jashtë shtetit (Hollandë, Gjermani) gjatë viteve 1995 – 1996.
- Ndërsa, për aktivitetin profesional ka deklaruar këto të dhëna:
- (i) Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Shtator 1993 – Dhjetor 1997);
- (ii) Nënkryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (1996 – 1997);
- (iii) Avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë, aktivitet i ushtruar në vazhdim dhe aktualisht, licence nr. 888.
4. Nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, datë 18.11.2016 me rend dite “*Shqyrtimi i kandidaturave për gjyqtarë, për plotësimin e 6 (gjashtë) vendeve vakant, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë*”, ka rezultuar se gjatë prezantimit të relacionit për votimin e kandidaturave, anëtari i KLD-së është shprehur se “*Dy kemi të skualifikuar, për shkak se nuk përmbushnin kriteret e ligjit, nuk kishin mbaruar as Shkollën e Magjistraturës, nuk ishin as gjyqtarë të mëparshëm. Janë zotërinjtë, njëri është zoti Luan Daci, i cili ka një vendim për “Shkarkim nga detyra” (vendimi nr. 6, datë 24.12.1997).*” Konkretisht, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është vënë në dispozicion Vendimi Nr. 6, datë

-
- 24.12.1997 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka vendosur *“Zoti Luan Daci, largohet nga detyra e gjyqtarit për shkelje të ligjës dhe paaftësi në detyrë”*.
5. Nga verifikimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se subjekti tregtar *“Luan Daci”* me NIPT K72218029T, me fushë veprimtarie *“Avokat”* është regjistruar në datën 18.10.2007 dhe cregjistruar në datën 22.09.2017.
 6. Nga proceverbali i Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* për përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit të Posacëm të Apelimit, datë 02.06.2017 rezulton se z. Luan Daci është shprehur *“po kështu kam një angazhim që nga viti 2000 deri në ditët e sotme në sistemin e drejtësisë nëpërmjet aplikimit të funksionit të avokatit”*. Në vijim të pyetjes së Komisionit lidhur me periudhën që ka punuar si avokat, z. Daci është përgjigjur se *“nga data 20.03.2000 kur kam marrë licencën e avokatit me autorizim të ministrit, zotit Ilir Panda.”* Më pas, Komisioni e ka pyetur *“Sa vjet keni punuar si gjyqtar dhe pse jeni larguar nga sistemi gjyqësor dhe keni kaluar avokat? Dhe për rekorde, kur keni filluar?”* Z. Daci, ndaj kësaj pyetje është përgjigjur se *“kam filluar në shtator të vitit 1993...nuk kam pasur ndonjë problem, dhe deri më 24 Dhjetor të vitit 1997 unë kam qenë gjyqtar në Gjykatën e Tiranës”*. Megjithatë, Komisioni ka kërkuar të marrë një përgjigje precize nëse ishte larguar vetë apo e kishin hequr, dhe z. Daci është përgjigjur se *“unë kam ikur me dorëheqje, sepse nuk na lejuan të regjistroheshim”*.
 7. Nga dokumentacioni zyrtar i marrë pranë Kuvendit të Shqipërisë rezulton se z. Luan Daci në datën 03.02.2017 ka bërë një kërkesë drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit me objekt *“Për aplikim, emërim të kërkuesit në vendet vakante të shpallura në bazë të ligjit Nr. 84/2016”*, në faqen e dytë të së cilës, pika (f) ka deklaruar *“ndaj meje nuk është marrë masë disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit”*. Ky deklaram i bërë nga z. Daci në një dokument zyrtar drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit provohet të jetë i pavërtetë pasi me Vendimin Nr. 6, datë 24.12.1997 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishte shkarkuar nga detyra për shkelje të ligjit dhe paaftësi në detyrë. Kjo vendimmarrje i ishte komunikuar edhe nga mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, datë 18.11.2016, i cili kishte vendosur skualifikimin e tij për pozicionin *“gjyqtar”* për shkak të shkarkimit nga detyra.

8. Në datën 03.03.2017, Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar me shkresën Nr. 57 Prot., datë 03.03.2017, Kryetarit të Kuvendit duke i vënë në dispozicion listën e kandidatëve që përmbushin kriteret formale për pozicionin e anëtarit të institucioneve të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik, si dhe listën e kandidatëve që nuk përmbushin kriteret formale. Në listën e kandidatëve që nuk përmbushin kriteret formale, rezultojnë edhe emrat e z. Ardian Hajdari dhe z. Luan Daci, me arsyen e njëjtë “*Nga dokumentacioni i paraqitur nuk plotëson kriterin e vjetërsisë në punë sipas gërmës b, pika 1, neni 6, ligji Nr. 84/2016*”, si dhe mangësi të tjera në dokumentacion.
9. Në datën 14.06.2017, z. Luan Daci është zgjedhur anëtar i Kolegjit të Posacëm të Apelimit.
10. Në median e shkruar dhe online gjenden disa artikuj lidhur me çështjet e sipërmendura, përkatësisht shkarkimin nga detyra dhe vjetërsinë në profesion.¹
11. Në datë 13.01.2020, i jam drejtuar me shkresë Kuvendit të Shqipërisë për marrjen e një kopje të plotë të dokumentacionit të depozituar për kandidatin z. Ardian Hajdari dhe z. Luan Daci. Kuvendi i Shqipërisë me shkresën Nr. 126/1 Prot., datë 14.01.2020 më ka përcjellë kopjen e dosjes personale të z. Luan Daci, paraqitur prej tij në zyrat e Avokatit të Popullit dhe prej këtij të fundit në Kuvend, kopje e procesverbalit të seancës dëgjimore me z. Luan Daci, mbajtur në Komisionin *ad hoc*, datë 02.06.2017, kopjen e dosjes personale të z. Ardian Hajdari, paraqitur prej tij në zyrat e Avokatit të Popullit dhe prej këtij të fundit në Kuvend, kopje e procesverbalit të seancës dëgjimore me z. Ardian Hajdari, mbajtur në Komisionin *ad hoc*, datë 02.06.2017.
12. Në datën 13.01.2020, i jam drejtuar me shkresë zyrtare Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili me shkresën Nr130/1 Prot., datë 15.01.2020 më ka përcjellë Vendimin Nr. 6, datë 24.12.1197 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të z. Luan Daci për shkak të shkeljes së ligjit dhe paaftësi në detyrë, procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, datë 18.11.2016, kërkesën e datës 12.11.2016 për emërimin si gjyqtar në shkallë të parë dhe jetëshkrimin bashkëlidhur kërkesës.

II. BAZA LIGJORE

¹ <https://shqiptarja.com/lajm/kush-është-gjyqtari-i-vettingut-i-shkarkuar-në-1997ën-prokurorja-që-mbeti-për-pasurinë-i-nxjerr-dokumentin-fotot;>
[https://ëëë.balkanëeb.com/skandali-anetari-i-kpa-luan-daci-fshehu-shkarkimin-nga-detyra-ne-97/;](https://ëëë.balkanëeb.com/skandali-anetari-i-kpa-luan-daci-fshehu-shkarkimin-nga-detyra-ne-97/)

13. Kushtetuta e Shqipërisë:

Neni 6/1

Ndalohet zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara nga Kushtetuta, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nese verifikohen rrethana që çënojnë integritetin e funksionarit publik, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 42

- 1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.*
- 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.*

Neni 125

- 3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.*
- 4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.*
- 5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.*

Neni 127

- 1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron kur:*

ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 128 të Kushtetutës;

d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese.

3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, organi i emërtesës emëron një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.

Neni C

Dispozita të përgjithshme për Komisionin dhe Kolegjin e Apelit

3. Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni. Gjyqtarët e Kolegjit të Apelit gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe mandati i tyre nuk kufizohet për shkak të moshës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

4. Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, komisionerët publikë, si dhe punonjësit e tjerë të këtyre institucioneve nënshkruajnë deklaratë me shkrim, sipas ligjit, për të autorizuar kryerjen e kontrollit vjetor të pasurisë së tyre, monitorimin sistematik të llogarive dhe transaksioneve financiare, si dhe kufizimet e posaçme të së drejtës së fshehtësisë së komunikimeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në detyrë. Deklaratat e pasurisë së tyre bëhen publike.

5. Anëtarët e Komisionit dhe gjyqtarët e Kolegjit të Apelit kanë arsim të lartë juridik dhe jo më pak se 15 vjet përvojë si gjyqtar, prokuror, lektor i së drejtës, avokat, noter, jurist i nivelit të lartë në administratën publike, ose në profesione të tjera ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë. Kandidatët për anëtarë të Komisionit dhe gjyqtarë të Kolegjit nuk duhet të kenë qenë gjyqtarë, prokurorë ose këshilltarë ligjorë apo ndihmës ligjorë gjatë dy vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kandidatët nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe funksione drejtuese në partitë politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

13. Anëtari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe Komisioneri Publik ushtrojnë detyrën me kohë të plotë dhe nuk mund të

mbajnë asnjë pozicion apo të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër gjatë kohëzgjatjes së mandatit.

14. Komisioni, Kolegji i Apelit dhe Komisionerët Publikë kanë buxhet, administratë dhe mjedise të mjaftueshme për të kryer funksionet e tyre si dhe për ushtrimin e funksioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë, sipas ligjit.

15. Gjuhët zyrtare të Komisionit, të Kolegjit të Apelit dhe komisionerëve publikë janë gjuha shqipe dhe angleze. Të dyja organet punësojnë përkthyes për këtë qëllim.

16. Anëtari i Komisionit, gjyqtari i Kolegjit të Apelit dhe Komisioneri Publik mban përgjegjësi disiplinore. Rastet e shkeljes disiplinore shqyrtohen nga Kolegji i Apelit, sipas ligjit.

14. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut:

Neni 6

E drejta për një proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

15. Kodi i Procedurës Penale:

Neni 240

Llojet e masave ndaluese

1. Masat ndaluese janë:

a) pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik;

Neni 242

Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik

1. Me vendimin që disponon pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, gjykata i ndalon përkohësisht të pandehurit, plotësisht ose pjesërisht, veprimtarinë që lidhet me to.

Neni 281

Kallëzimi nga nëpunësit publikë

1. Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një veprë penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale.

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve

1. Çdo person që ka marrë dijeni për një veprë penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

16. Kodi Penal:

Neni 190

Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve

Falsifikimi ose përdorimi i vulave, i stampave apo i formularëve të falsifikuar ose paraqitja e rrethanave të rreme në këto të fundit, që u drejtohen organeve shtetërore, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

17. Ligji Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”;

Neni 6

Kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit

1. Anëtar i Komisionit dhe gjyqtar i Kolegjit të Apelimit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

b) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të ketë marrë një vlerësim të lartë për aftësitë e tij profesionale, etike dhe integritetin moral të tij, nëse u është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit;

gj) zotëron shumë mirë gjuhën angleze.

2. Përmbushja e kriterëve të mësipërme vlerësohet duke marrë në konsideratë në veçanti të dhënat si më poshtë:

a) titujt shkencorë në fushën e së drejtës;

b) përvojë të veçantë të kandidatit në sfera të caktuara të së drejtës;

c) vjetërsinë në profesion;

ç) përvojën studimore dhe profesionale jashtë shtetit shqiptar;

d) notën mesatare jo më pak se 8, nëse ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit, dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

18. Ligji Nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”:

Neni 7/a

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

a) vjetërsisë në profesion;

b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;

c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;

ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;

d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;

dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

Neni 9

Mbarimi i mandatit

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron në rastet e mëposhtme:

ç) shkarkohet, sipas parashikimeve të nenit 128 të Kushtetutës;

d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese.

III. ANALIZA LIGJORE

Në lidhje me kompetencën e Prokurorisë së Posacme:

19. Kushtetuta e Shqipërisë dhe ligji Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” kanë parashikuar se Kolegji i Posacëm i Apelit funksionon si një trupë gjyqësore e posacme pranë Gjykatës Kushtetuese. Kolegji i Apelit ndihmohet dhe mbështetet nga strukturat e Gjykatës Kushtetuese, dhe gjyqtari i Kolegjit të Apelit gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Statusi i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nënkupton se gjyqtari i Kolegjit të Apelit, përveçse sa është parashikuar shprehimisht për të në Kushtetutë dhe ligjin Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i nënshtrohet të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që ka gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese.
20. Neni 148 i Kushtetutës ka parashikuar se Prokuroria e Posacme kryen hetimin dhe ndjekjen penale për akuzat penale ndaj subjekteve të parashikuara nga neni 135, pika 2 e Kushtetutës. Ndërsa, neni 135, pika 2 e Kushtetutës ka parashikuar një listë subjektësh, gjykimi i të cilëve është kompetencë ekskluzive e Gjykatës së Posacme, për rrjedhojë edhe hetimi e ndjekja e tyre penale kryhet nga Prokuroria e Posacme. Ndër këto subjekte bëjnë pjesë edhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Këto dy dispozita kushtetuese sa i përket hetimit, ndjekjes penale dhe gjyqimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese gjejnë vend për t’u aplikuar edhe në rastin e gjyqtarit të Kolegjit të Posacëm të Apelit. Kjo pasi ky Kolegj funksionon si dhomë e vecantë e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e tij jepen në emër të Gjykatës Kushtetuese, dhe cka është më e rëndësishmja gjyqtarët e Kolegjit të Apelit kanë status të njëjtë me gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese. Në rastin konkret, kjo do të thotë se në rast se për një gjyqtar të Kolegjit të Posacëm të Apelit ka një akuzë penale, atëherë hetimi i saj është kompetencë ekskluzive e Prokurorisë së Posacme. Në

rastin konkret, z. Luan Daci është gjyqtar i Kolegjit të Apelimit, akuzat penale ndaj të cilit duhet të hetohen nga Prokuroria kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

21. **Konkluzion:** Nga sa më sipër, është e qartë se gjyqtari i Kolegjit të Apelimit gëzon status të njëjtë me gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese. Kjo nënkupton jo vetëm të drejta dhe përfitime të njëjta, por edhe detyrime e përgjegjësi të njëjta. Konkretisht, Kushtetuta parashikon se gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese hetohet dhe ndiqet penalisht nga Prokuroria e Posacme. Ky parashikim gjen vend dhe duhet të zbatohet edhe në rastin e gjyqtarit të Kolegjit të Posacëm të Apelimit, ndaj të cilit nëse ngrihet një akuzë penale duhet të hetohet nga Prokuroria e Posacme. Në rastin konkret, akuza penale që ngrihet nëpërmjet këtij kallëzimi për z. Luan Daci me detyrë gjyqtar i Kolegjit të Posacëm të Apelimit duhet të hetohet dhe ndiqet penalisht nga Prokuroria kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Në lidhje me falsifikimin e formularëve nëpërmjet deklarimit të dhënave të rreme:

22. Jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë ka arritur një qëndrim të konsoliduar lidhur me elementët e veprës penale që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative që një person të ngarkohet me përgjegjësi penale. Përkatësisht, në mënyrë që të ndodhemi përpara një veprë penale duhet të bashkëekzistojnë katër elementë të veprës penale: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive.² Në vijim të këtij kallëzimi, do të analizojmë në mënyrë të detajuar secilin prej këtyre elementëve, të cilët provojnë se z. Ardian Hajdari ka konsumuar të katër elementët e veprës penale të falsifikimit të formularëve nëpërmjet deklarimit të dhënave të rreme, të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal.
23. **Objekti:** Objekti i veprës penale ka të bëjë me marrëdhënien juridike ose vlerën e rëndësishme shoqërore ose shtetërore që legjislatori ka synuar të mbrojë nëpërmjet normës penale, duke parashikuar sanksionin penal në rast të cënimit të saj. Në rastin e veprës penale të falsifikimit të formularëve, objekti i veprës penale është marrëdhënia juridike që garanton veprimtarinë e rregullt të organeve të administratës publike, si dhe të personave privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumenteve nga

²Vendimi Nr. 4, datë 15.04.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
Vendimi Nr. 3, datë 02.11.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;

veprimet ose mosveprimet që sjellin si pasojë cënimin e ligjshmërisë së funksionimit të këtyre organeve, si dhe të drejtave apo interesave të ligjshme të shtetasve.³ Pra, legjislatori ka synuar të mbrojë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar plotësimin e rregullt të formularëve kur iu drejtohen organeve shtetërore.⁴ Përsa më lart, është e qartë se qëllimi që ka synuar të arrijë legjislatori është një qëllim me interes të lartë publik që lidhet me plotësimin në mënyrë të rregullt, të kujdesshme dhe të saktë të të dhënave në dokumentet zyrtare që iu drejtohen institucioneve shtetërore. Deklarimi i rrethanave të rreme në këto formularë mund të dëmtojë jo vetëm funksionimin e rregullt të organeve shtetërore, por edhe të drejtat e ligjshme të shtetasve.

24. Në rastin konkret, marrëdhënia juridike që legjislatori ka synuar të mbrojë është deklarimi në mënyrë të rregullt dhe të saktë të të dhënave nga ana e kandidatëve për gjyqtar në Kolegjin e Posacëm të Apelitit qoftë përpara institucionit të Avokatit të Popullit, i cili kishte detyrën kushtetuese dhe ligjore të administrimit të dokumentacionit të aplikantëve dhe përcjelljes së tyre, qoftë përpara Kuvendit të Shqipërisë, i cili kishte detyrën kushtetuese dhe ligjore që bazuar në dokumentacionin e administruar të përzgjidhte gjyqtarët. Deklarimi i rregullt, i plotë dhe i saktë i të dhënave nga ana e kandidatëve, të cilët eventualisht do të përzgjidheshin si anëtarë të institucionit kushtetues për rivlerësimin në shkallë të dytë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kishte dy qëllime kryesore. Nga njëra anë, garantohej legjitimiteti i institucionit, i cili duhej të ngrihej në përputhje të plotë me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, dhe nga ana tjetër, garantohej të drejtat e subjekteve të rivlerësimit, të cilët gëzojnë të drejtën e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Koncepti i gjykatës së caktuar me ligj, nënkupton që gjyqtarët të jenë përzgjedhur në përputhje me ligjin.
25. Me veprimet e tij aktive, sic do të shpjegojmë në analizën e anës objektive të veprës penale, z. Luan Daci ka cënuar rëndë marrëdhënien juridike që ka synuar të mbrojë neni 190 i Kodit Penal. Kjo pasi z. Daci në deklaratimet e tij përpara institucionit të Avokatit të Popullit, ashtu edhe përpara Kuvendit të Shqipërisë, ka paraqitur rrethana të rreme, të cilat nëse do të dihejshin nga institucionet e sipërmendura do të sillnin si pasojë moszgjedhjen e tij si gjyqtar i Kolegjit të Posacëm të Apelitit. Duke vepruar kështu, nga

³Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Vendimi nr. 24, datë 09.02.2018;

⁴Prof.Dr. Ismet Elezi, "E Drejta Penale, Pjesa e Posacme", fq. 316, Tiranë 2016;

njëra anë z. Daci ka cënuar rëndë legjitimitetin e institucionit kushtetues, i cili në përbërje të tij ka anëtarë të zgjedhur në kundërshtim me parashikimet e Kushtetutës dhe ligjit, dhe nga ana tjetër, ka cënuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të subjekteve të rivlerësimit, përkatësisht të drejtën e tyre për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Nga sa më sipër, është e qartë se në rastin konkret përmbushet elementi i parë lidhur me objektin e veprës penale.

26. **Ana objektive:** Ana objektive e veprës penale ka të bëjë me veprimet ose mosveprimet e kundërligjshme nëpërmjet të cilave është cënuar marrëdhënia juridike e mbrojtur nga norma penale. Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se elemente të anës objektive të figurës së veprës penale janë: i) veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm; ii) mënyra e kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet renditja e veprimeve, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e veprës penale; iii) koha, vendi dhe ambienti i kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe uniteti i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal. Në rastin e veprës penale të falsifikimit të formularëve, ana objektive lidhet me falsifikimin e formularëve apo paraqitjes së të dhënave të rreme në këto të fundit që u drejtohen organeve shtetërore.⁵ Kështu, falsifikimi i formularëve nëpërmjet deklarimit të të dhënave të rreme përbëhet nga tre elementë: i) paraqitja e rrethanave të rreme; ii) në formularë zyrtarë; iii) të cilët iu drejtohen organeve shtetërore.
27. Në rastin konkret, vepra penale e falsifikimit të formularëve nëpërmjet paraqitjes së të dhënave të rreme mund të realizohet praktikisht që në dokumentacionin e depozituar pranë institucionit të Avokatit të Popullit të paraqiteshin të dhëna të rreme, pjesërisht apo tërësisht të pasakta, si dhe duke mosdeklaruar të dhëna të caktuara, të cilat do të përbënin shkak për moszgjedhjen e kandidatit në përbërjen e Kolegjit të Posacëm të Apelit. Nga faktet e parashtruara në paragrafët 1 – 11 të “*Rrethanat e çështjes*”, vërtetohet se z. Luan Daci me veprimet e tij aktive ka deklaruar të dhëna të rreme përpara institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* me qëllim zgjedhjen e tij si anëtar i Kolegjit të Apelit. Deklarimet e kryera nga z. Daci, të cilat në gjykimin tim

⁵ Prof.Dr. Ismet Elezi, “*E Drejta Penale, Pjesa e Posacme*”, fq. 316, Tiranë 2016;

-
- përmbushin elementin e anës objektive të veprës penale, do të analizohen në vijim të këtij kallëzimi në mënyrë të detajuar.
28. **Së pari**, neni 6 i ligjit Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” parashikon se “anëtari i Kolegjit të Posacëm të Apelimit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme: c) të ketë marrë një vlerësim të lartë për aftësitë e tij profesionale, etike dhe integritetin moral të tij, nëse u është nënvlerësuar vlerësimet e mëparshme; dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna”. Kjo dispozitë ka synuar që të garantojë që gjyqtari i Kolegjit të Apelimit të jetë një person me integritet të lartë profesional dhe moral, cilësi për të cilat duhet të jetë dalluar nëse i është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme. Po ashtu, ligji ka synuar që të mbrojë përbërjen e institucioneve të rivlerësimit nga individët ndaj të cilëve është marrë masa disiplinore e largimit nga puna apo edhe masa të tjera disiplinore më të buta, të cilat janë akoma në fuqi.
29. Në rastin konkret, gjyqtari i Kolegjit të Apelimit z. Luan Daci ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në periudhën 1993 – 1997. Me Vendimin Nr. 6, datë 24.12.1997, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur “Zoti Luan Daci, largohet nga detyra e gjyqtarit për shkelje të ligjës dhe paaftësi në detyrë”. Ky fakt është konstatuar edhe nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, datë 18.11.2016, vetëm tre muaj përpara se z. Daci të aplikonte për t’u përzgjedhur si gjyqtar i Kolegjit të Apelimit. Megjithatë, referuar procesverbalit të Komisionit Parlamentar Ad Hoc, datë 02.06.2017 për përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit të Posacëm të Apelimit z. Daci është shprehur se ai është larguar me dorëheqje. Ky deklaram rezulton i pasaktë referuar Vendimit të sipërcituar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si edhe procesverbalit të mbledhjes së KLD-së. Po ashtu, në kërkesën e datës 03.02.2017 drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit me objekt “Për aplikim, emërim të kërkuesit në vendet vakante të shpallura në bazë të ligjit Nr. 84/2016”, në faqen e dytë të së cilës, pika (f) ka deklaruar “ndaj meje nuk është marrë masë disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit”. Ky deklaram i bërë nga z. Daci në një dokument zyrtar drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit provohet të jetë i pavërtetë pasi me Vendimin Nr. 6, datë 24.12.1997 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishte shkarkuar nga detyra për shkelje të

-
- ligjit dhe paaftësi në detyrë. Kjo vendimmarrje i ishte komunikuar edhe nga mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, datë 18.11.2016, i cili kishte vendosur skualifikimin e tij për pozicionin “gjqqtar” për shkak të shkarkimit nga detyra. Është e qartë se në shkresën drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit z. Daci ka deklaruar të dhëna të rreme, për të cilat ka qenë plotësisht në dijeni. Vlen për t’u theksuar se në jetëshkrimin e depozituar pranë institucionit të Avokatit të Popullit, i cili më pas është vënë në dispozicion edhe të Kuvendit për përzgjedhjen e tij, nuk ka pasur asnjë referencë lidhur me eksperiencën e tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Është e kuptueshme se kjo është bërë me qëllim për të fshehur gjurmët e mënyrës se si ai ishte larguar nga sistemi.
30. Nga sa më sipër, është e qartë se z. Luan Daci është larguar nga detyra si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor me vendim shkarkimi për shkelje të ligjit dhe paaftësi në detyrë. Ky fakt rezulton nga Vendimi Nr. 6, datë 24.12.1997 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe po ashtu, nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, datë 18.11.2016. Kjo rrethanë përbën një kusht ndalues për z. Luan Daci për t’u zgjedhur si gjyqtar i Kolegjit të Apelimit në kuptim të gërmave c) dhe dh), pika 1 e nenit 6 të ligjit Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Mosdeklarimi i kësaj rrethane është bërë me qëllim zgjedhjen e tij si anëtar i Kolegjit të Posacëm të Apelimit edhe pse kjo vinte në kundërshtim me ligjin, i cili kërkonte shprehimisht që ndaj gjyqtarit të Kolegjit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga detyra.
31. **Së dyti**, neni C i Aneksit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” ka parashikuar se “gjqqtarët e Kolegjit të Apelimit gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese”. Po ashtu, në këtë nen është parashikuar se “gjqqtarët e Kolegjit të Apelimit kanë arsim të lartë juridik...gjuhët zyrtare të Kolegjit të Apelimit janë gjuha shqipe dhe gjuha angleze”. Më tej, këto kritere janë detajuar në nenin 6 të ligjit Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i cili parashikon se “gjqqtari i Kolegjit të Apelimit duhet të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i Shkencave”, zotëron shumë mirë gjuhën angleze...përmbushja e kritereve vlerësohet duke marrë parasysh të dhënat si më poshtë: titujt shkencorë në fushën e së drejtës, përvojën studimore dhe profesionale jashtë shtetit shqiptar, notë mesatare jo më pak se 8”.

-
32. Ligji ka parashikuar se gjyqtari i Kolegjit të Apelimit duhet të ketë një notë mesatare jo më pak se 8 të studimeve të larta për drejtësi. Ky kriter është vendosur për të emëruar në pozicionin e rëndësishëm të gjyqtarit të Kolegjit të Apelimit, individë që kanë arritur rezultate të larta gjatë studimeve tyre. Në rastin konkret, nëpërmjet krahasimit të jetëshkrimit të vënë në dispozicion pranë institucionit të Avokatit të Popullit për aplikimin për gjyqtar të Kolegjit të Apelimit dhe atij të depozituar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë për aplikimin për gjyqtar të Gjykatës së Tiranës, si dhe deklarimeve përpara Komisionit Parlamentar Ad Hoc, vihen re disa mospërputhje që meritojnë vëmendje. Në jetëshkrimin e depozituar pranë KLD-së, z. Daci ka deklaruar se mesatarja e studimeve të tij është 9, ndërkohë në jetëshkrimin e depozituar pranë Avokatit të Popullit ka deklaruar se mesatarja është 8.24. Po ashtu, në deklarimet përpara Komisionit Parlamentar Ad Hoc ka deklaruar se mesatarja e studimeve të Fakultetit është 8.4. Pra, në tre raste të ndryshme, z. Luan Daci ka deklaruar mesatare të ndryshme të studimeve. Pavarësisht se ne nuk e disponojmë listën e tij të notave, ajo që dihet me siguri është se të tre këto shifra nuk mund të përputhen me realitetin. Kriteri i mesatares është një kriter i rëndësishëm, i cili nëse nuk plotësohet sipas kërkesës ligjore të nenit 6 të ligjit Nr. 84/2016 mund të përbëjë kusht për pazgjedhshmërinë në institucionet e rivlerësimit. Nga deklarimet e ndryshme të z. Daci mund të ngrihet dyshimi i arsyeshëm se ai ka deklaruar së paku në dy raste të dhëna të pasakta sa i përket mesatares së tij të studimeve.
33. Po ashtu, ligji ka parashikuar se në vlerësimin e arsimit dhe aftësive profesionale të kandidatit duhet të mbahen parasysh titujt shkencorë, përvoja profesionale studimore jashtë vendit. Kjo pasi për gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit kërkohet që ata të jenë të dalluar në rradhën e profesionistëve të së drejtës dhe me kualifikime të vecanta, si rezultat i të cilave janë vlerësuar me grada apo tituj shkencorë. Në rastin konkret, rezulton se z. Luan Daci jo vetëm nuk mban asnjë titull apo gradë shkencore dhe nuk ka asnjë përvojë studimore jashtë shtetit shqiptar, por edhe ato të deklaruara në Shqipëri janë të pasakta. Kështu në jetëshkrimin e tij, z. Daci ka deklaruar se ka ushtruar kurse të Magjistraturës në Shkollën e Magjistraturës, Shqipëri gjatë viteve 1995 – 1996. Ky deklarim i zotit Luan Daci është i pasaktë në dy drejtime. E para, Shkolla e Magjistraturës ka filluar aktivitetin e saj në Tetor 1997 dhe në periudhën 1995 – 1996, të cilës i referohet z. Daci kjo shkollë akoma nuk ekzistonte. E dyta, ky deklarim bie në

-
- kundërshtim edhe me vetë deklarinimet përpara Komisionit Parlamentar Ad Hoc, në të cilat është shprehur se ai u largua nga sistemi pasi nuk u lejua të regjistrohej në Shkollën e Magjistraturës. Pra, nuk ekziston asnjë mundësi reale që z. Daci të jetë trajnuar në Shkollën e Magjistraturës, sic edhe ka deklaruar në jetëshkrimin e tij.
34. **Së treti**, neni C i Aneksit “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve*” ka parashikuar se “*Gjyqtarët e Kolegjit të Apelit kanë jo më pak se 15 vjet përvojë si gjyqtar, prokuror, lektor i së drejtës, avokat, noter, jurist i nivelit të lartë në administratën publike, ose në profesione të tjera ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë.*” Ndërsa, neni 6 i ligjit Nr. 84/2016 “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve*” ka parashikuar se “*Gjyqtari i Kolegjit të Apelit duhet të ketë 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës*”. Po ashtu, ky nen ka përcaktuar se në vlerësimin e përgjithshëm të kandidatit për gjyqtar të Kolegjit të Apelit duhet të merret në konsideratë përvoja e vecantë të kandidatit në sfera të caktuara të së drejtës dhe vjetërsia në profesion.
35. Kushtetuta dhe ligji kanë përcaktuar se gjyqtari i Kolegjit të Apelit duhet të ketë një përvojë pune 15 (pesëmbëdhjetë) vjecare si gjyqtar, prokuror, lektor i së drejtës, avokat, noter ose jurist i nivelit të lartë në administratën publike. Nga jetëshkrimi i z. Daci rezulton se ndër profesionet e mësipërme, ai ka ushtruar profesionin e gjyqtarit gjatë periudhës 1993 – 1997 dhe avokatit pa dhënë ndonjë periudhë të caktuar, por vetëm “*aktivitet i ushtruar në vazhdim dhe aktualisht*”. Megjithatë, sa i përket profesionit të avokatit në deklarinimet përpara Komisionit Parlamentar Ad Hoc, z. Daci është shprehur se “*kam punuar avokat që nga data 20.03.2000 kur kam marrë licencën e avokatit me autorizim të ministrit, zotit Ilir Panda*”. Pra z. Daci ka deklaruar se ai ka punuar 4 (katër) vite si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) vite si avokat.
36. Megjithatë, referuar fakteve të përmendura në paragrafët 2 dhe 5 të “*Rrethanat e çështjes*” rezulton se deklarinimet e z. Daci janë të pasakta. Ndryshe nga sa ai pretendon përpara Komisionit Parlamentar Ad Hoc për marrjen e licencës së avokatit në datën 20.03.2000 nga ministri Ilir Panda, nga dokumentet e depozituara pranë institucionit të

Avokatit të Popullit rezulton një dokument “*Leje Nr. 888, datë 27.03.2000 Për ushtrimin e profesionit të avokatit*”, i lëshuar më 27.03.2000 dhe i nënshkruar nga z. Kleanthi Koci. Ky dokument përveçse se përmban një datë dhe autoritet zyrtar të ndryshëm nga ato të deklaruara nga z. Daci, përmban edhe dy parregullsi të tjera thelbësore. Së pari, nënshkruesi i këtij dokumenti z. Kleanthi Koci rezulton se ka ndërruar jetë në datën 21.02.1999, pra një vit përpara lëshimit të këtij dokumenti. Së dyti, leja është plotësuar me shkrim dore dhe nuk përmban asnjë referencë për numër regjistri apo numër protokoli.

37. Në praktikën e institucioneve të rivlerësimit është konsoliduar qëndrimi se zotërimi i lejes së ushtrimit të profesionit, nuk vërteton ushtrimin faktik të tij, pasi për të vërtetuar ushtrimin e profesionit duhet provuar edhe me dokumentacion shoqërues nga regjistri tregtar, organet tatimore, sigurimet shoqërore, shëndetësore etj. Neni 30 i ligjit Nr. 8560, datë 22.12.1999 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” parashikonte se çdo person e fiton të drejtën të ushtrojë veprimtari ekonomike vetëm pasi regjistrohet në gjykatë. Pas këtij regjistrimi, ai detyrohet të kërkojë paisjen me certifikatë tatimore. Ndërsa, neni 39 i ligjit Nr. 9920/2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” parashikon se si numër identifikimi për qëllime tatimore për tatimpaguesin që është individ shërben numri personal i identifikimit i marrë në përputhje me ligjin. Sipas nenit 40 të këtij ligji, personat fizikë dhe juridikë e ushtrojnë veprimtarinë ekonomike tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”. Kjo do të thotë që një person të ushtrojë veprimtari ekonomike, ai duhet të jetë detyrimisht i regjistruar në organet tatimore dhe regjistrin tregtar, përndryshe e ushtron veprimtarinë në kundërshtim me ligjin. Veprimtaria ekonomike e ushtruar në kundërshtim me ligjin nuk mund të konsiderohet si vjetërsi në profesion për rastin e gjyqtarit të Kolegjit të Apelit pasi vjen në kundërshtim me nenin 6, pika 1, gërma c) të ligjit Nr. 84/2016. Në rastin konkret, nga dokumentet e depozituara nga z. Luan Daci nuk rezulton asnjë dokument që të provojë veprimtarinë e tij ekonomike për vitet të cilat ai ka deklaruar se ka ushtruar profesionin e avokatit, pra asnjë vërtetim nga organet tatimore, regjistri tregtar, sigurimet shoqërore e shëndetësore etj.

-
38. Në rastin konkret, nga ekstrakti historik i subjektit “Luan Daci” me NIPT K72218029T, me objekt “Avokat” rezulton që qoftë deklaratimet e bëra me shkrim përpara institucionit të Avokatit të Popullit, qoftë ato përpara Komisionit Parlamentar Ad Hoc, sado që ato janë kontradiktore mes tyre janë të pasakta. Nga ekstrakti rezulton se subjekti “Luan Daci” është regjistruar më 18.10.2007 dhe është cregjistruar më 22.09.2017. Ky fakt provon se z. Daci e ka ushtruar profesionin e avokatit vetëm për rreth 10 vite, të cilat nëse do t’i bashkonim me eksperiencën e tij katër vjecare si gjyqtar, sërish nuk përmbushet kriteri ligjor 15 vjet i vjetërsisë në profesion. Ky fakt vërtetohet edhe nga shkresa Nr. 57 Prot., datë 03.03.2017 që institucioni i Avokatit të Popullit i ka dërguar Kryetarit të Kuvendit, nëpërmjet të cilës i vë në dispozicion listën e kandidatëve që përmbushin kriteret formale, ashtu edhe të atyre që nuk i përmbushin kriteret. Z. Luan Daci rezulton në listën e subjekteve që nuk përmbushin kriteret formale për shkak se “*Nga dokumentacioni i paraqitur nuk vërtetohet kriteri i vjetërsisë në punë, sipas gërmës b, pika 1, neni 6, i ligjit 84/2016*”, si dhe mangësi të tjera në dokumentacion. Nga sa më sipër, provohet qartësisht se z. Luan Daci ka deklaruar të dhëna të rreme së paku në tre raste lidhur me (i) masën e largimin nga detyra “shkarkim për shkak të shkeljes së ligjës dhe paaftësi në punë”; (ii) kurset profesionale në Shkollën e Magjistraturës 1995 – 1996, dhe (iii) vjetërsinë në profesion. Të tre këto deklaratime të vlerësuara në tërësinë e tyre përmbushin elementin e anës objektive të veprës penale të “Falsifikimit të formularëve”.
39. **Subjekti:** Subjekti i veprës penale ka të bëjë me personin që nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të tij kryen veprën penale.⁶ Në rastin e veprës penale të falsifikimit të formularëve, subjekt mund të jetë cdo shtetas që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm.⁷ Në rastin konkret, subjekt aktiv i veprës penale është z. Luan Daci, i cili ushtron detyrën e gjyqtarit të Kolegjit të Apelit, dhe përmbush të gjitha kërkesat ligjore për të qenë subjekt i veprës penale. Për sa më sipër, cmojmë se përmbushet edhe elementi i tretë i veprës penale.
40. **Ana subjektive:** Ana subjektive e veprës penale lidhet me aftësinë e personit për të kuptuar pasojat e veprimeve të tij dhe qëndrimin që personi mban ndaj këtyre pasojave.

⁶ Prof.Dr. Skender Kacupi, Prof.Dr. Maksim Haxhia, Prof.Asoc.Dr. Dorina Hoxha, “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, fq. 113, Tiranë 2018;

⁷ Prof.Dr. Ismet Elezi, “E Drejta Penale, Pjesa e Posacme”, fq. 317, Tiranë 2016;

Në rastin e veprës penale të falsifikimit të formularëve, vepra penale kryhet me dashje direkte (*dolus directus*)⁸. Kjo do të thotë që personi i parashikon pasojat e veprës penale, lejon ardhjen e tyre dhe i dëshiron ato. Në rastin konkret, është e kuptueshme se veprimet e paligjshme të z. Luan Daci janë kryer me dashje direkte pasi vetëm në këtë mënyrë ai mund të zgjidhej gjyqtar në Kolegjin e Posacëm të Apelimit. Nëse z. Daci do të deklaronte në mënyrë të saktë largimin nga detyra me masë disiplinore, arsimin dhe vjetërsinë në profesion, atëherë ai nuk do të përmbushte kriteret e parashikuara nga Neni C i Aneksit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” të Kushtetutës dhe nenit 6 të ligjit Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Për sa më sipër, është e qartë se në rastin konkret përmbushet edhe elementi i anës subjective pasi z. Daci i ka parashikuar pasojat e veprimeve të tyre dhe ka dëshiruar ardhjen e tyre, pra zgjedhjen e tij si anëtar i Kolegjit të Posacëm të Apelimit.

41. **Konkluzion:** Nga sa më sipër, është e qartë se veprimet e gjyqtarit të Kolegjit të Posacëm të Apelimit z. Luan Daci përmbushin katër elementët e veprës penale të falsifikimit të formularëve. Konkretisht, me deklaratimet e tij të rreme pranë Avokatit të Popullit dhe Kuvendit të Shqipërisë, z. Daci ka cënuar legjitimitetin e Kolegjit të Posacëm të Apelimit dhe të drejtat e subjekteve të rivlerësimit. Këto veprime janë kryer me dashje direkte, pasi vetëm në këtë mënyrë z. Daci mund të zgjidhej gjyqtar në Kolegjin e Apelimit. Pra, ai ka parashikuar ardhjen e pasojave dhe i ka dëshiruar ato. Në kushtet kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme se janë përmbushur të katër elementët e veprës penale të falsifikimit të formularëve, Prokuroria duhet të kryejë hetime të plotë dhe të gjithëanshme për të nxjerrë përpara përgjegjësisë shkelësit e ligjit.

Në lidhje me pezullimin e ushtrimit të detyrës:

42. Neni 242 i Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar si një ndër masat ndaluese pezullimin e ushtrimit të detyrës publike. Masat ndaluese zbatohen ndaj atyre që para procedimit për një vepër penale kanë kryer funksione apo detyra publike. Zakonisht vepra penale e kryer prej këtyre personave ka lidhje me veprimtarinë, detyrën apo shërbimin ose me veprimtarinë profesionale. Masat ndaluese mund të zbatohen vetëm kur

⁸ Vendimi nr. 24, datë 09.02.2017, Gjykata e Lartë, fq. 8.

procedohet për vepra penale, për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit.⁹ Pra, ligji, jurisprudenca dhe doktrina kanë përcaktuar tre kriterë për marrjen e masës së pezullimit të ushtrimit të detyrës: (i) ushtrimin e një detyre publike; (ii) vepra penale ka lidhje me detyrën, dhe (iii) veprat penale dënohet me më shumë se një vit,.

43. Në rastin konkret, z. Luan Daci i përmbush të gjitha kërkesat ligjore për marrjen e masës së pezullimit të ushtrimit të detyrës së tij. Konkretisht, z. Luan Daci ushtron detyrën e gjyqtarit të Kolegjit të Posacëm të Apelimit dhe vepra penale lidhet pikërisht me zgjedhjen e tij në këtë detyrë. Vepra penale, e cila i atribuohet z. Daci, përmban dënimin me burg nga gjashtë muaj deri në katër vjet, pra përmbushet edhe kriteri i tretë. Krahas kriterëve ligjore, të cilat sic analizuam më sipër përmbushen në rastin konkret, marrja e kësaj mase ka një rëndësi të vecantë edhe për të ruajtur të pacënuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Forcimi i besimit të publiku të sistemi i drejtësisë ishte një nga arsyet kryesore të ndërmarrjes së reformës kushtetuese e ligjore në drejtësi. Për më tepër, qëndrimi në detyrë i z. Daci cënon edhe të drejtën kushtetuese të subjekteve të rivlerësimit për t'u gjykuar nga një gjykatë, e caktuar me ligj në kushtet kur ky gjyqtar është në kushtet e pazgjedhshmërisë sipas Kushtetutës dhe ligjit Nr. 84/2016. Në këto kushte, marrja e masës së pezullimit nga detyra është emergjente dhe duhet vendosur sa më parë.

IV. KONKLUZIONI

I/E nderuar z./znj. Prokuror/e,

44. Prej 17 vitesh ushtroj profesionin e nderuar të prokurorit të Republikës së Shqipërisë, herë si prokuror i thjeshtë e herë të tjera si drejtues prokurorie. Gjatë gjithë kësaj karriere, jam përpjekur të punoj me ndershmëri dhe integritet, duke u vlerësuar kurdoherë me “shumë mirë” nga organet kompetente. Megjithatë, duke parë fenomenet shqetësuese në sistemin e drejtësisë, ashtu si pjesa më e madhe e trupës së prokurorëve të ndershëm të këtij vendi e kemi mirëpritur reformën në drejtësi, përfshirë edhe rivlerësimin kalimtar të

⁹ Halimi Islami, Prof.Dr. Artan Hoxha, Dr. Ilir Panda, “Procedura Penale”, fq. 329 – 330, Tiranë 2012;

gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sic evidentohet edhe nga vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që ka vendosur konfirmimin tim në detyrë, unë kam qenë kurdoherë bashkëpunues dhe i gatshëm për t'iu përgjigjur cdo kërkesë të këtij institucioni sepse kam besuar deri në fund që në fund ky institucion do të jepte drejtësi.

45. Megjithatë, pasi kam marrë dijeni për faktet tronditëse në lidhje me gjyqtarin e Kolegjit të Apelit z. Luan Daci, i cili është pjesë e trupës gjyquese që do të vendosë për fatin tim si prokuror, besimi në këtë proces më është lëkundur. Për këtë kam vendosur të mos hesht, ashtu sic nuk kam bërë asnjëherë ndaj padrejtësive apo shkeljeve të ligjit, por të ndërmarr dy veprime, të cilat i konsideroj të duhurat dhe besoj se do i kishte ndërmarrë cdo koleg i ndershëm në sistemin e prokurorisë. Së pari, t'i drejtoj një kërkesë Kolegjit të Posacëm të Apelit për deklarimin e mbarimit të mandatit të këtij anëtari dhe së dyti, ta kallëzoj penalisht shtetasin z. Luan Daci, i cili në gjykimin tim ka konsumuar të gjithë elementët e veprës penale të falsifikimit të formularëve të kryer nëpërmjet deklarimit të rrethanave të rreme.
46. Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal, ligjin Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ligjin Nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, përfundimisht,

KËRKOJ:

- (i) Kryerjen e hetimeve të plota dhe të gjithanshme për z. Luan Daci, dhe nxjerrjen e tij përpara organeve të drejtësisë.

Me konsideratë,

Besnik CANI

(_____)